



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 11 nëntor 2011  
Nr. ref.:RK157/11

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUSHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 09/11**

Parashtruesi

**Mustafë Aliu**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut Ac. nr. 1326/2008, të datës 27.02.2009 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Komunale CI. nr 1176/07, të datës 12.06.2008**

### **GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

Njëzëri miraton Aktvendimin mbi papranueshmërinë, që ka të bëjë me kërkesën.

Kryetari i Gjykatës, Prof. Dr. Enver Hasani, në përputhje me nenin 18, par. 1, pika 1.3 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 03/L -121) ka deklaruar konfliktin e interesit pasi që rasti që shqyrtohet nga Gjykata ka të bëjë me institucionin ku kishte punuar paraprakisht, dhe ka kërkuar përjashtimin e tij përgjatë tërë procedurës së shqyrtimit të këtij rasti. Pasi që kërkesa e tij është aprovuar nga gjyqtarët, Kryetari nuk mori pjesë në asnjë nga fazat e shqyrtimit dhe të procesit të vendimmarrjes për këtë lëndë.

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues i kërkesës është z. Mustafë Aliu, mësimdhënës në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit të Universitetit të Prishtinës.

## **Vendimet e sfiduara**

2. Vendimet e sfiduara në Gjykatën Kushtetuese janë:

Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë Ci. nr. 1176/07, i datës 12.06.2008; dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1326/2008, i datës 27.02.2009.

## **Çështja e lëndës**

3. Çështje bazë e lëndës së parashtruar në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 24 janar 2011, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 1326/2008, të datës 27.02.2009, me anë të cilit është refuzuar ankesa e Universitetit të Prishtinës, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë Ci. nr. 1176/07, i datës 12.06.2008, me anë të të cilit z. Mustafë Aliu i është aprovuar kërkesëpadia, dhe Universiteti Prishtinës është detyruar që z. Mustafë Aliu t'ia mundësojë kryerjen e detyrave të Dekanit të Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit sipas vendimit Ref. Nr. 1/38, të datës 12.06.2006.

## **Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara kushtetuese**

4. Edhe pse me nenin 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar, z. Mustafë Aliu në kërkesën e tij nuk ka qartësuar se cilat të drejta pretendon se i janë shkelur, edhe pse në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës ai ka theksuar se pretendon se janë shkelur neni 21.22,23 dhe neni 113 i Kushtetutës (të drejtat e njeriut-parimet e përgjithshme, zbatimi i drejtpërdrejt i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, dinjiteti i njeriut dhe jurisdikcioni, dhe palët e autorizuara për ngritje).

## **Baza juridike**

5. Neni 113.7 lidhur me nenin 21.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Përmbledhje e procedurës në Gjykatë**

6. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese më 24 janar 2011.
7. Më 26 janar 2011, Gjykata Kushtetuese me shkresën zyrtare Ref: DRLSA- 168/11/sk, kishte njoftuar Gjykatën Komunale në Prishtinë lidhur me kërkesën që e ka në shqyrtim dhe nga kjo gjykatë ka kërkuar zyrtarisht aktvendimet e saja lidhur me kërkesëpadinë e z. Aliu, e që mungojnë në dosjen e lëndës që e ka në shqyrtim Gjykata Kushtetuese.
8. Po të njëjtën ditë, në përgjigjeje të shkresës së Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Komunale ia ka dërguar aktvendimet e kërkuara.
9. Më 1 shkurt 2011, me shkresën Ref. nr.: DRLSA-244 /11/sk, Gjykata ka njoftuar Universitetin e Prishtinës për kërkesën e parashtruar nga z. Aliu dhe ka kërkuar komentet eventuale të UP-së lidhur me këtë kërkesë.

10. Më 14 shkurt 2011, Universiteti i Prishtinës ka dërguar përgjigje me shkrim lidhur me këtë kërkesë, në të cilën ka theksuar se UP nuk mund të bëjë asnjë lloj kompensimi për z. Mustafë Aliu pasi që ai realisht nuk e ka kryer punën e Dekanit të Fakultetit të Kulturës Fizike.
11. Më 12 prill 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Altay Suroy, Kolegji shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami, anëtarë, brenda të njëjtës ditë i paraqiti rekomandimet e veta për të refuzuar lëndën si të palejueshme para përbërjes së plotë të Gjykatës.

### **Ankesa e parashtruesit**

12. Parashtruesi i kërkesës ankohet se Universiteti i Prishtinës, pa ndonjë justifikim ligjor, nuk e ka ekzekutuar Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Nr. 1326/2008, me të cilin kjo Gjykatë ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Universitetit të Prishtinës dhe kishte vetëtuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë Ci. nr. 1176/07, të datës 12.06.2008, e që me atë Aktgjykim ishte aprovuar kërkesëpadia e z. Mustafë Aliu, dhe Universiteti i Prishtinës ishte detyruar që paditësin ta kthejë në vendin e punës - Dekan i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në Prishtinë, post ky nga i cili ishte shkarkuar me vendimin e Rektoratit.

### **Faktet**

13. Më 12 qershor 2008, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin Ci .nr. 1176/07 ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e z. Mustafë Aliu, ish-Dekan i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit dhe ka anuluar vendimin e të paditurës-UP-së për shkarkimin e tij nga pozita e Dekanit (Vendimi-ref. nr 1/38 i datës 12.06.2006.) dhe ka obliguar të paditurën që paditësin – z. Mustafë Aliu ta kthejë në vendin e punës-Dekan i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit në kuadër të UP-së.
14. Më 27 janar 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin Ac. nr. 1326/2008 kishte refuzuar ankesën e Universitetit të Prishtinës dhe ka vërtetuar Aktgjykimin Gjykatës Komunale Ci. nr 1176/07.
15. Më 30 qershor 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktvendimin E 530/09 kishte aprovuar propozimin për përmbarim të z. Mustafë Aliu dhe kishte caktuar ekzekutimin e propozuar.
16. Më 25 gusht 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktvendimin E. nr 530/09 kishte refuzuar kundërshtimin e debitorit – Universitetit të Prishtinës kundër aktvendimit për lejimin e ekzekutimit të aktgjykimeve të Gjykatës Komunale dhe asaj të Qarkut në Prishtinë, të cilat ishin të favorshme për kreditorin z. Mustafë Aliu.
17. Më 2 shtator 2009, z. Mustafë Aliu i kishte dërguar një shkresë Universitetit të Prishtinës duke kërkuar kthimin e tij në vendin e punës – Dekan i FKFS-së duke u thirrur në aktgjykime të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme të gjykatave të rregullta.
18. Më 29 mars 2010, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktvendimin Ac. nr. 1079/ 2009, përfundimisht kishte APROVUAR si të bazuar ankesën e debitorit-Universiteti i Prishtinës dhe kishte shfuqizuar Aktvendimin për përmbarim E 530/09 të Gjykatës Komunale të Prishtinës, duke e deklaruar këtë çështje përmbarimore si të përfunduar.

19. Z. Mustafë Aliu, në kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese, ka pretenduar edhe për shkelje tjera kushtuese dhe ligjore të drejtuara ndaj kolegëve të tij, dhe në emër të këtyre parregullsive të supozuara ka prezantuar kontrata pune të z. Rexhep Murati, z. Azem Hajdari, vendime të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, procesverbale të Senatit të UP-së dhe kopjen e Statutit të UP-së.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë**

20. Për të qenë në gjendje për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata paraprakisht i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës ku thuhet:

**“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.**

Nenet 47 e 49 të Ligjit për Gjykatë Kushtetuese që përcaktojnë se:

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale, të garantuara me Kushtetutë, janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

Neni 49 (Afatet):

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

21. Duke shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur në kërkesën e parashtruesit, por edhe atë të siguruar sipas detyrës zyrtare nga Gjykata Komunale e Prishtinës lidhur me procedurën përmbaruese e që është në lidhmëri të drejtpërdrejt me çështjen që e shqyrton, Gjykata Kushtetuese e Kosovës konstatoi në mënyrë të padiskutueshme se vendimin e fundit, z. Mustafë Aliu e ka pranuar më 20.04.2010 (Aktgjykimi Ac. nr 1079/ 2009 ) dhe ky fakt u konstatua nga kopja e fletëdërgesës për dorëzim personal të nënshkruar personalisht nga vetë z. Aliu, ndërsa kërkesën në Gjykatën Kushtetuese e kishte dorëzuar më 24 .01.2011, pra rreth 8 muaj përtej afatit prej katër muajsh të paraparë me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës për të parashtruar një kërkesë individuale para saj.
22. Në këto kushte, kërkesa duhet të refuzohet si e paafatshme (shih mutatis mutandis. Blečić v. Kroacisë, kërkesa Nr. 59532100, Vendim i GJEDNJ-se i datës 29 korrik 2004 ). Një arsyetim të tillë Gjykata Kushtetuese e kishte përdorur në Rastin Nr. KI 33/09 - Fillim Musa Guga kundër vendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, SCEL-08-0001 i datës 17 qershor 2008 dhe SCEL -08-0001 i datës 10 shtator 2008.
23. Gjykata më tej vëren se, edhe sikur kërkesa e parashtruesit të ishte paraqitur brenda afatit kohor prej katër muajve, të paraparë me nenin 49 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ajo prapë se prapë do të duhej të refuzohej si haptazi e pabazuar, sepse parashtruesi i saj nuk ka paraqitur prova të cilat prima facie do të tregonin se atij i janë shkelur të drejta të garantuara me Kushtetutë.
24. Në fakt, edhe pse Gjykata Komunale dhe ajo e Qarkut në Prishtinë, gjatë shqyrtimit të kontestit të punës, kishin aprovuar kërkesëpadinë e tij dhe kishin urdhëruar kthimin e z, Aliu në pozitën e Dekanit në FKFS të UP-së, Gjykata e Qarkut në Prishtinë në

procedurën përmbartimore me Aktvendimin Ac. nr. 1079/ 2009, kishte "refuzuar" ekzekutimin e saj duke e cilësuar si të papërmbartueshëm dhe duke marrë parasysht Ligjin për Procedurën Përmbartimore (Ligji nr. 03 /L-008) i cili me nenin 14.1 ka paraparë që - "Kundër aktvendimit të nxjerrë në formë të prerë në procedurën përmbartimore dhe të sigurimit nuk lejohet revizioni as përsëritja e procedurës", kësaj çështje juridike i ka dhënë fund ligjor.

25. Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike, të drejtë dhe të plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore, prandaj nuk mund të veprojë si "Gjykate e shkallës së katërt", (shih mutatis mutandis, i.a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).
26. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën, shihet se parashtruesi i saj nuk e ka përmbushur obligimin ligjor të saktësimi të kërkesës, sepse ai nuk ka specifikuar qartë se cila e drejtë e garantuar me Kushtetutë i është cenuar nga aktet e autoriteteve publike. Për me tepër, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se Gjykatës, gjate dëgjimit të rastit, i mungonte paanshmëria ose që procedura ishte e padrejtë. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (shih mutatis mutandis Aktgjykim ECHR Appl. No. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005)
27. Për sa i përket shkeljeve të tjera kushtetuese, që parashtruesi i kërkesës i thekson në kërkesë dhe për të cilat pretendon se i janë cenuar, Gjykata rithekson se në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese theksohet se për të pasur të drejtë të paraqitjes së një kërkesë individuale në Gjykatën Kushtetuese, pala duhet të dëshmojë se të "drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik", pra, në fakt duhet ta dëshmojë cenimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë ndaj tij dhe jo personave të tjerë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës nuk njeh një "actio popularis", apo të drejtën e ngritjes së çështjeve kushtetuese nga secili individ, a person juridik, pa pasur paraprakisht interesin direkt në atë çështje.
28. Në këto rrethana, kërkesa është e paafatshme, qartazi e pabazuar, andaj parashtruesi nuk i ka plotësuar kërkesat për pranueshmërinë e kërkesës, dhe


## PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 36.3 (h) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese në seancën e datës 12 prill 2011, njëzëri:

### VENDOSI


- I. TA HEDHE POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Vendimi do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Altay Suroy

**Zëvendëskryetari i Gjykatës Kushtetues**



Mr. Sc. Kadri Kryeziu